Kronikë

Kapen mallra kontrabandë në Portin e Durrësit, sekuestrohen 600 fishekzjarrë dhe një sasi alkooli

Dy raste të kontrabandës së mallrave të ndryshme (për disa prej tyre paguhet akcizë), janë goditur në Portin e Durrësit, nga një operacion i përbashkët ndërmjet Doganës dhe Policisë Kufitare

HOROSKOPI

Redaksia
27 Dhjetor, 14:18 | **Përditesimi: 27 Dhjetor, 14:41**

Share

Dy raste të kontrabandës së mallrave të ndryshme (për disa prej tyre paguhet akcizë), janë goditur në Portin e Durrësit, nga një operacion i përbashkët i zhvilluar ndërmjet Doganës dhe Policisë Kufitare.

Konkretisht është vënë në hetim B. C., 24 vjeç, banues në Kurbin, pasi gjatë kontrollit në automjetin tip "Benz" që drejtonte, iu gjetën 6 kuti me nga 100 fishekzjarrë secila, të padeklaruara;

Po ashtu është proceduar penalisht edhe O. A., 57 vjeç dhe Xh. H., 32 vjeç, të dy banues në Durrës, pasi gjatë kontrollit në autobusin e tyre, iu gjetën rreth 200 shishe me pije të ndryshme alkoolike, pajisje të ndryshme elektroshtëpiake (mallra për të cilat paguhet akcizë) dhe mallra të tjera të padeklaruara.

LEXO EDHE:

Mbrëmjen e së enjtes Orkestra e Harqeve organizon koncertin festiv në teatrin 'Aleksandër Moisiu'! Dirigjenti flet për mungesën e vlerësimit ndaj artistëve

Në përfundim të veprimeve procedurale, fishekzjarrët dhe mallrat e tjera u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Po ashtu edhe në terren Krimi Ekonomik në Durrës ka goditur 2 raste të shitjes së mallrave të kontrabanduara, për të cilat janë proceduar penalisht shtetasit: D. Ç., 39 vjeç, banues në Durrës, pasi gjatë kontrollit në dyqanin e tij, në lagjen nr.4, Durrës, iu gjetën pije të ndryshme alkoolike të kontrabanduara, pa pullë fiskale, të cilat ky shtetas i shiste duke fshehur të ardhurat;

Po ashtu u procedua A. V., 33 vjeç, banues në Durrës, pasi gjatë kontrollit në automjetin e tij, shërbimet e Policisë gjetën qindra paketa me cigare, të kontrabanduara, pa pullë fiskale, të cilat ky shtetas po i transportonte me qëllim shitjen.

M.Q./KT/Shqiptarja.com

TAG: mallra kontrabande | Durres | porti i durresit

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM
Sondazhi i ditës:
SPAK do policë tek dera e ndalim komunikimi për Berishën, si e vlerësoni?
Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Solli naftë ruse për biznesmenin Ilir Bello, hiqet sekuestroja e anijes "Grace Felix" me 22 mijë ton naftë! S'u provua kontrabanda
27 Dhjetor, 11:05

Plan me Dedan Gjonin për t'i bërë atentat 'Akilit', publikohet videoja e arrestimit të 'Kep Rapit' në Durrës
26 Dhjetor, 15:47

'Tempulli'/ Me heroinë e kokainë në makinë, pranga 31-vjeçarit në Durrës
26 Dhjetor, 14:54

U dërguan për çështje sigurie në Fier, kthehen në Burgun e Durrësit, Vangjush Dako dhe Alqi Bllako
26 Dhjetor, 11:23

Besimtarët festojnë Krishtlindjet në Durrës, mbahet mesha në Kishën Ortodokse 'Apostull Pavli dhe Shën Asti'
25 Dhjetor, 11:05

Mbahet mesha e Krishtlindjes, mblidhen qindra qytetarë në Durrës dhe Lushnje
24 Dhjetor, 23:24

Durrësi koncert festiv në prag Krishtlindje, qytetarët dynden në shesh
24 Dhjetor, 22:21

Festat bashkojnë familjet, shqiptarët kthehen në atdhe! Numër i lartë hyrjesh në Kakavijë, Kapshticë, Morinë dhe në Portin e Durrësit e Vlorë
24 Dhjetor, 09:21

Atmosferë festive në Durrës, panairi 'Verë dhe Traditë' mbledh qytetarët në shesh
Aldo Mustafa
23 Dhjetor, 17:24

Destinacionet e preferuara për fundvit, Vathi: Kryeson Durrësi, preferohet edhe nga të huajt! Prenotimet e shqiptarëve jashtë janë rritur me 25%
22 Dhjetor, 20:33


Zyrtare/ Teuta gjen shpëtimin në Serie A, në Durrës prezantojnë mbrojtësin e Kombëtares
22 Dhjetor, 16:23

Ish-shefi i Krimeve Dedan Gjoni i përfshirë në një tjetër tentativë vrasje, plan me të 'fortin e Durrësit' për t'i bërë atentat 'Akilit'! 4 të arrestuar
Sokol Dema
22 Dhjetor, 09:45

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje